

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI”, PËR
SPITALIN RAJONAL MEMORIAL FIER**

**KODI PËRKHATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): (FPP)
15894200-3.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 40,168,125 (dyzetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e njëzetë e pesë) Lekë (pa TVSH) ose **390,437** (treqinde e nentëdhjetë mijë e katerqind e tridhjetë e shtate) Euro (pa TVSH);

**Vlera ne Euro 102.88 Referuar Kursit të këmbimit - Përditesimi i fundit: 23.11.2023 ora:
12:02.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**“SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI PËR SPITALIN RAJONAL
MEMORIAL FIER”**

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Ne zbatim te rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarres duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore.

Shënim 1.1:

Operatori ekonomik ne zbatim te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”, konkretisht neni 19, per cdo stabiliment qe disponon (pronesi dhe/ose qira) te paraqes tabelen me informacion si me poshte:

Nr.	Vendodhja	Statusi	Nr. i regjistrimit te posacem
1		Pronesi/qira/perdorim	
Etj.		Pronesi/qira/perdorim	

Detyrimisht cdo stabiliment duhet te jete i pajisur me licence perkatese. Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*
2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto shëbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të

deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të realizuara.

b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të realizuara.

2. Operatori Ekonomik duhet të vërtetoj se disponon 1 (një) ambient, brenda Bashkisë në të cilin ndodhet AK përfitues i këtij shërbimi, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

➤ **Dokumentacioni që vërteton pronësinë:**

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ **Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:**

- Kontratë huaje.

➤ **Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:**

- Kontratë qiraje.

Shënim 2.1: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarohej plotësimi i standardeve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi ose me qira, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Targen e mjetit	Njësia	Sasi minimale	Statusi
1			copë		Në pronësi ose me qira

Shënim 2.3:

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë dokumentacionin pranë AK dokumentacion për mjetet e mësipërme, që vërtetojnë pronësinë, qiranë, ose huapërdorjen, (certifikate pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje si dhe çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) si dhe lejen e qarkullimit të mjetit.

Mjetet që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

4. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të ketë jo më pak se 7 (shtatë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1.	Drejtues Teknik (Mercollog/Kimist)	1
2.	Kuzhinier	1
3.	Ndihmes Kuzhinier	2
4.	Punonjes shperndares ushqimesh ne ambjentet e AK	2
5.	Shofer	1
	Total	7 (shtatë)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për drejtuesin teknik/(Mercollog/Kimist) te paraqitet:

- Diplomë me profesion Mercollog/Kimist.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën perkatese.
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të leshuar nga e - albania.

b) Për Kuzhinierin te paraqitet:

- Diplome ose çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën perkatese
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të leshuar nga e – albania.

c) Për ndihmes kuzhinier te paraqitet:

- Kontrate pune.
- Librezë pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën perkatese.
- Duhet të ketë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të leshuar nga e - albania.

d) Për punonjesit per shperndarje ushqimi, te paraqitet:

- Kontratë pune.

e) Për punonjesin Shofer, te paraqitet:

- Kontratë pune
- Leje Drejtimi për mjetet e kërkuara, në përputhje me Legjislacionin në fuqi.

➤ Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes

Shënim: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar të cdo punonjesi pranë AK.

Shënim 2.4:

Me qëllim garantimin e gjithë përfshirjes, për të dhënë mundësi çdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën përkatëse të prokurimit, punonjësit e mesipër jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik enkas për këtë procedurë prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Stafi i cili do të paraqitet Autoritetit Kontraktor, për zbatimin e kësaj kontrate, konkretisht stafi i kërkuar në pikën d) nuk duhet të jete të angazhuar në kontrata të tjera, deri në përfundim të kontratës. Për këtë arsye të paraqitet deklarate përkatëse nga Administratori/Drejtuuesi Ligjor i shoqërisë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), operatori ekonomik ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Shënim 2.5: Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së kontratës me autoritetin kontraktor ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se mundëson transportimin e ushqimit me mjetet e veta, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor.
7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se ushqimi do të etiketohet dhe do të identifikohet nëpërmjet dokumenteve dhe çdo lloj informacioni tjetër, për të siguruar gjurmueshmërinë e tij sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
8. Operatori ekonomik duhet të deklarojë disponimin ose mundësinë e disponimit të materialeve dhe mjeteve profesionale të domosdoshme/inventari i imët, të kërkuara në shtojcën 5 të DT.
9. Operatori ekonomik për produktet në specifikimet teknike sipas shtojcës nr. 5, duhet të paraqesë Fletë Analizë nga një organ i akredituar kombëtar ose nderkombëtar. Fletë Analizat të jenë kryer brenda 30 ditëve para datës së hapjes së ofertave.
10. Pas klasifikimit dhe para publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, AK do të kërkojë nga OE pjesëmarrës që me stafin e deklaruar në pikën 5 të Seksionit 2.3, të përgatiten dietat nr.3 nr.12. nr.13, të përcaktuara në shtojcën nr.5, në një prej ambienteve të OE i cili duhet ta përcaktoj nëpërmjet një deklarate.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1 dhe germa b,c,d e pikës 5 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori

ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të praqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuesë, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Data e publikimit të njoftimit është **10.08.2023** dhe data e zhvillimit të procedurës së prokurimit elektronik është **11.09.2023 ora: 11:00** në faqen e internetit www.app.gov.al, në Ministrinë e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.